ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **33600-24-1755-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me pajisje sportive për Institucionet Korrektuese**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" INFINITT " SH.P.K.**
NUI	**601614177**
Adresa	**Dëshmorët e Kombit**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044/974-590**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Astrit Uka**
Adresa elektronike	**infinitt.shpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**21.06.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me pajisje sportive për Institucionet Korrektuese

Njoftimi per kontrate: 04.03.2024.

Afati i fundit për dorzimin e ofertav: 25.03.2024.

Data dhe ora e hapjes se ofertav: 25.03.2024. ora 13:30

Njoftimi mbi vendimin e AK 1: 19.04.2024.

Njoftimi mbi vendimin e AK 2: 31.05.2024.

Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkese per ri-shqytim kemi parashtruar me 04.06.

Vendimin per refuzimin e kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar me 11.06.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve
Neni 60- Kriteret per dhenie te kontrates
Neni 61- Tenderët Jo-Normalisht të Ulët
Neni 66- Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 19 I UOPP-se- Specifikimet Teknike
Neni 30 i Rregullore per prokurim publik- Validiteti i Tenderit
Neni 41 I Rregullore per prokurim public- Tenderët Jo-normalisht të Ulët
Neni 44.3 I Rregullores per prokurim public- Formularët Standard
Neni 40 i UOPP-se Ekzaminimi, veresimi dhe krahasimi i tendereve
Neni 108/A pika 6- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK/Komisioni vlersues gjatë ri-vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe rregulloren për prokurim publik.
AK/zyra e prokurimit me 19.04. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate kompanine tone si oferta e pergjegjshme me cmimin me te ulet per kete aktivitet te prokurimit.
Pas kerkeses per ri-shqyrtim te dorezuar nga OE Office Trade sh.p.k. AK me 24.04. ka pezulluar aktivitetin e prokurimit dhe lenda eshte kthyer ne ri-vleresim.
Pas ri-vleresimit te ofertav AK me vendimin e dates 31.05. ka rekomanduar per kontrate po OE ankues Office Trade sh.p.k.
Me 31.05. kemi derguar kerkese per qasje ne dokumente zyrtare dhe qasja na eshte lejuar/aprovuar nga AK per daten 03.06.sipas kerkeses sone.
Nga dokumentet te cilat i kemi pranuar konstatojme se AK ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili ne baze te mostrav te dorezuara nuk ploteson specifikimet teknike per pozicionin nr.12 ne specifikacionin e tenderit Ore stopuese pasiqe kerkesa ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit per projektin ne fjale ka qene qe ora stopuese te jete me

10matje ndersa mostra e dorezuar nga OE i rekomanduar per kontrate ka 6 matje, citoj kerkesen e AK ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit
Operatori ekonomik i cili synohet dhënia e kontratës do ti kërkohen mostrat për te gjithë artikujt. Mostrat do te verifikohen nga komisioni i vlerësimit. **Nëse mostrat nuk janë sipas specifikave te kërkuara tenderi do te refuzohet.** Kërkesa për mostra i dërgohet operatorit tjetër.
Prandaj mare parasysh shenimin e lartecekur oferta e OE eshte dashur te refuzohet pasiqe nuk ploteson specifikimet teknike si ne DT.
Ky pretendim ankimor fare nuk eshte shqyrtuar nga AK ne vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim.
Poashtu OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ploteson kerkesat e pershtatshmerise profesionale per projektin ne fjale.
Ne baze te dokumenteve te biznesit te cilat OE ka dorezuar ne ofertim shihet se kompania veprimtari primare ka tregtine me pakice dhe shumice te librav, materialev te shtypit, publikimin e revistav dhe sherbime te tjera te shtypit.
Ne kete aktivitet te prokurimit prokurohen artikuj/rekuizita sportive dhe OE i rekomanduar per kontrate nuk ploteson kerkesat e pershtatshmerise profesionale konform nenit 66 te LPP-se pasiqe aktiviteti primar dhe sekondar i percaktuar ne ARBK nuk perkon me natyren e ketij aktiviteti te prokurimit.
Ne vleresimin e pare autoriteti kontraktues ka eleminuar kompanine Office trande me arsyetimin se cmimorja e dorezuar eshte e nje aktiviteti tjeter te prokurimit, jo aktivitetit te prokurimit per te cilin ka aplikuar, OE perveq qe ka doreuzar cmimoren e aktivitetit tjeter poashtu eshte i papergjegjshem pasiqe deklarata nen betim nuk permban shenimet e dosjes se tenderit.
Numri i Prokurimit: 33600-24-1755-1-2-1 – Titulli Furnizim me pajisje sportive për Institucionet Korrektuese
Kjo nderhyrje ne dosjen e tenderit bie ndesh me nenin 44.3 te rregullores per prokurim publik, citoj:
44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave.
Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard **pa ndryshime në përmbajtje**, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, **ose pa fshirjen e ndonjë kushti** të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes
„header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde. Ne kete menyre OE Office trande eshte i papergjegjshem pasiqe me apo pa dashje ka fshire te dhenat e paraqitura nga AK ne header: titullin dhe nr e prokurimit.
Ky pretendim ankimor fare nuk eshte shqytuar nga AK ne vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim.
Office trade sh.p.k. poashtu eshte i papergjegjshem pasiqe oferta e tij eshte jo-normalisht e ulet, Autoriteti kontraktues i eshte drejtuar me leter standarde per informata per tenderet jo-normalisht te ulet duke kerkuar zberthimin e cmimeve konform nenit 41.8 te rregullores per prokurim publik dhe pikes 2 te nenit 61 te LPP-se:
2.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

OE ne pergjigje te kerkeses ka bashkangjitur nje mareveshje me kompanine Europrinty dhe per te faktuar se oferta e tij eshte jo-normalisht e ulet ka bashkangjitur dhjetera dokumente unike doganore (DUD) ne emer te kompanise Europrinty te cilet kane permbajtje:
DUD1. Zmadhues zeri me bloututh, DUD2. Dosja me vrime prej plastike, kuti per dhurata, spirale DUD3. Kuti e parave cash, kuti per qelsa, markera DUD4. Leter termike per shtypshkronja, qanta krahu dhe paisje per ushtrime fizike duke mos specifikuar qfar paisje. DUD5. Printer, kutia te zbrasta dhe lapsa kimik, DUD6. Pena me maje te rumbullaket, varese per qelsa, regjistrator me dy unaza. DUD7. Hilzne per prodhim te letrav fiskale, leter termike, fletore per shenime me spirale DUD8. Filgjana prej qeramike, lapsa kimik, etiketa vetngjitese DUD9. Aparate per mirmbajtjen e fytyre, metra prej tekstili, prerese per leter DUD10. Lojra- zare, varse prej silikoni me vakum, bilbil per referim qe eshte i vetmi produkte per te cilin OE ka dorezuar deshmi per koston e blerjes.
Ne kete menyre pas pranimit te informacioneve AK/Zyra e prokurimit konfirm pikes 4 te nenit 61 te LPP-se eshte dashur te eleminoj OE Office trade si te papergjegjshem pasiqe nuk ka dorezuar deshmi te mjaftueshme per te argumentuar se oferta e dorezuar per kete aktivitet te prokurimitnuk eshte jo-normalisht e ulet.
OE si deshmi per te arsyetuar cmimet per rekuizita sportive se nuk jane jo-normalisht te uleta ka ofruar deshmi/ dokumente unike doganore per material zyrtar qe nuk mund te meren parasysh nga AK pasiqe nuk perkojne deshmite/sqarimet e dorezura me produktet te cilat ka ofertuar.
Autoriteti kontraktues pas analizimit te deshmive/ dokumentet unike doganore te dorezuara nga OE i rekomanduar per kontrate eshte dashur te veproje konform nenit 41.8 te Rrpp dhe nenit 61.4 te LPP-se.
Shkelje tjera procedurale ne kete aktivitet te prokurimit eshte se AK nuk ka kerkuar nga OE zgjatjen e vlefshmerise se ofertes dhe sigurimit te tenderit konform nenit 30.4&30.5 te rregullores per prokurim publik. Ne kemi bere zgjatjen e vlefshmerise se ofertes dhe sigurimit te ofertes ne menyre vullnetare pa kerkesen e AK.
Poashtu AK nuk ka respektuar nenin 108/a pasiqe kerkesa per ri-shqyrtim nuk eshte shqyrtuar brenda afatit ligjor 3dite pune si dhe nuk jemi njoftuar per zgjatjen e afatit per shqyrtimin e ankeses konform pikes 6 te nenit 108/a.
Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AK ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili nuk ploteson specifikimet teknike te parashtruara nga AK si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit dhe ka dorezuar oferte jo-normalisht te ulet si dhe eshte i papergjegjshem administrativisht per arsyejet e cekura me larte prandaj kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisioni vleresues ka ardhe deri tek dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem, ne kete menyre na eshte mohuar fitimi simbolik i paramanduar nga kjo kontrate dhe nuk eshte respektuar neni 60 i LPP-se qe kontrata ti ipet kompanise sone si tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet.

Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*